Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) ka monitoruar shkallën e pajtueshmërisë së qendrave për punë sociale (QPS) me legjislacionin e Kosovës dhe parimet e sundimit të ligjit dhe të drejtave të njeriut, me theks të veçantë nëse punëtorët socialë marrin pjesë në shqyrtimet gjyqësore ku janë të përfshirë fëmijët dhe u përgjigjen kërkesave të gjykatës për mendime profesionale.

Kuadri ligjor i Kosovës parasheh disa lloje të procedurave gjyqësore, si civile ashtu edhe penale, ku gjykata i thërret punëtorët socialë për të marrë pjesë në shqyrtim gjyqësor dhe/ose kërkon mendim profesional nga përfaqësuesi përkatës i QPS-së. Në këto raste, gjykata mbështetet në QPS-të për të bërë vlerësime profesionale dhe për të dhënë rekomandime në lidhje me rrethanat sociale. Për më tepër, në rastet kur i kërkon ekspertizë QPS-së, gjykata mund të mos e nxjerrë vendimin përfundimtar deri sa të mos e ketë bërë shqyrtimin e duhur të përmbajtjes dhe rekomandimeve të mendimit të QPS-së.

Pavarësisht detyrimeve të qarta për QPS-të të parapara si me kornizën ligjore të Kosovës ashtu edhe me standardet ndërkombëtare, OSBE vazhdon të monitorojë lloje të ndryshme të çështjeve gjyqësore ku QPS ka dështuar ta mbrojë interesin më të mirë të fëmijës, qoftë si rrjedhojë e mosparaqitjes së tyre në procedurë gjyqësore apo për shkak të mosveprimit dhe mosdhënies së një kontributi përmbajtësor në procedurë. Viteve të shkuara OSBE ka nxjerrë disa raporte tjera ku konstatohen shqetësime të ngjashme, përfshirë këtu raporte që shqyrtojnë llojet e procedurave të birësimit, rolin e QPS-ve në procedurë civile dhe në rastet e dhunës në familje. Me gjithë rekomandimet e qarta për hapat që duheshin ndërmarrë për të bërë përmirësime, disa prej problemeve vazhdojnë të jenë të pranishme ende.

Ky raport shqyrton gjetjet e Misionit, përfshirë edhe përmes disa shembujve ilustrues, bashkë me një sërë rekomandimesh për institucione të ndryshme të Kosovës për sa u përket modaliteteve për përmirësimin e situatës aktuale. Mangësitë më brengosëse që shtjellohen në këtë raport kanë të bëjnë me mosparaqitjen e punonjësve socialë në shqyrtime gjyqësore, të mos qenit aktiv në procedurë, si edhe dorëzimin e raporteve të mangëta e me vonesë në çështjet gjyqësore ku ishin të përfshirë fëmijët.

---

**Shënim:** Hulumtimet për këtë raport janë realizuar në periudhën 2017-2019. Atëbotë, institucion kryesor ekzekutiv për këtë fushë ishte Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS). Me shkrirjen e dikastereve në vitin 2020, Departamenti për Politika Sociale dhe të Familjes i cili më parë ka vepruar në kuadër të MPMS, në kohën e publikimit të këtij raporti është bartur nën ombrellën e Ministrisë së Shëndetësisë. Ky raport do t'i referohet ministrisë së mëparshme duke qenë se në kohën e realizimit të hulumtimit tonë ka shërbyer si organ ekzekutiv me mandat ligjor në këtë fushë, ndërsa rekomandimet do t'i adresohen Ministrisë së Shëndetësisë.



## 2. Hyrje

Sipas Këshillit të Evropës,

*“situata në të cilën ndodhen fëmijët në një shtet është shpesh një tregues i gjendjes së gjithmbarshme për sa i përket respektimit të të drejtave të njeriut në atë shtet, veçanërisht ngase fëmijët përbëjnë një prej grupeve më të ndjeshme të shoqërisë.”<sup>1</sup>*

QPS-të që funksionojnë nën ombrellën e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) janë pikë kryesore referimi në çështjet që kanë të bëjnë me interesat e një fëmije. QPS është institucion publik me personel të përbërë nga nëpunës të shërbimeve sociale me trajnime dhe kualifikime përkatëse të cilët janë përgjegjës për ushtrimin e kompetencave të parapara me ligj dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare në emër të MPMS.<sup>2</sup> Sa herë që një fëmijë të përfshihet në çfarëdoqilësie në procedurë gjyqësore, angazhimi i QPS-së është i detyrueshëm.<sup>3</sup> QPS ushtron rol aktiv si “organ i kujdestarisë” në procedurat sipas Ligjit për familjen.<sup>4</sup> Organi i kujdestarisë “është i autorizuar të bëjë propozime për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të fëmijëve, të paraqesë fakte të cilat nuk janë përfshirë, të propozojë administrimin e provave të domosdoshme, të ushtrojë mjete juridike dhe të ndërmer veprime të tjera gjyqësore.”<sup>5</sup> Veç kësaj, Ligji për familjen parasheh që “gjykata është e obliguar të ftojë në gjyq organin e kujdestarisë pjesëmarrës në procedurë në të gjitha seancat gjyqësore dhe t’i dorëzojë atij të gjitha vendimet.”<sup>6</sup> Gjykata mund t’i kërkojë QPS-së që të sigurojë një gamë të gjerë kontributesh e informatash në raste të birësimin,<sup>7</sup> raste të mbrojtjes së fëmijëve<sup>8</sup> ose raste të shkurorëzimit.<sup>9</sup>

Që nga viti 1999, sistemi i drejtësisë për të miturit dhe fëmijët ka qenë fushë prioritare e monitorimit për OSBE-në. Prandaj, gjatë tërë këtyre viteve janë monitoruar dhe raportuar rregullisht rastet në të cilat kërkohej përfshirja e QPS-së.<sup>10</sup> Fatkeqësisht, akoma vazhdojnë të jenë evidente disa prej çështjeve të raportuara rregullisht përgjatë viteve, e që flasin për nevojën për ngritje të kapaciteteve dhe trajnime për zyrtarët e QPS të cilët janë të angazhuar në fusha që kanë të bëjnë me fëmijët. Mangësitë më brengosëse përfshijnë, por jo vetëm, mosparaqitjen e punëtorëve socialë nga QPS në seanca gjyqësore, të mos qenit aktiv në procedurë, si edhe raportet joadekuate të përpiluara për rastet lidhur me caktimin e kujdestarisë,

1 Dokument mbi qëndrimet e Komisionerit të Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut në lidhje me të drejtat e fëmijëve, Strasburg, 03 maj 2010, CommDH/Position Paper [2010] 1.

2 Shih nenin 7 të Ligjit nr. 02/L-17 për shërbime sociale dhe familjare të datës 21 prill 2005 dhe plotësim-ndryshimet me Ligjin nr. 04/L-081 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-17 për shërbime sociale dhe familjare të datës 26 mars 2012.

3 Ligji nr. 2004/32 për familjes i datës 20 janar 2006, dhe plotësim-ndryshimet e tij me Ligjin nr. 06/L-077 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për familjen nr. 2004/32 të 21 dhjetorit 2018, neni 3(2) i përkufizon fëmijët si persona nën moshën 18 vjeçare.

4 Shih nenin 6 të Ligjit për familjen.

5 Shih nenin 6(4) të Ligjit për familjen.

6 Po aty., neni 6(4).

7 Po aty., Neni 168(3).

8 Shih nenin 10(11) të Ligjit për shërbime sociale dhe familjare.

9 Shih nenin 140(2) të Ligjit për familjen.

10 Shih Raportet e OSBE: “Qendrat për punë sociale në procedurat civile”, Botimi i II-të, mars 2010.

[<https://www.osce.org/kosovo/67517?download=true>]; “Procedura për birësimin e fëmijëve në Kosovë”, Botimi i VI-të, gusht 2010

[<https://www.osce.org/kosovo/71205?download=true>]; “Gjykimi i kërkesave për urdhra për mbrojtje në rastet e dhunës në familje në Kosovë”,

mars 2012. [<https://www.osce.org/kosovo/88713?download=true>].

mbajtjen financiare dhe ushqimin dhe mbajtjen e kontakteve personale mes fëmijëve dhe prindërve. Të gjitha këto shqetësime, përfundimisht, shkojnë në dëm të vet fëmijëve të përfshirë në procedura gjyqësore nga lëmi i së drejtës familjare dhe procedura gjyqësore të tjera.

Ky raport bazohet në (i) vlerësimin cilësor dhe sasior të rasteve nëpër gjykata ku janë të përfshirë fëmijët që janë monitoruar në periudhën 2017-2019; (ii) intervistat e diskutimet me përfaqësues të institucioneve gjegjëse gjyqësore dhe jogjyqësore; dhe (iii) vrojtime të bazuara në programin afatgjatë të monitorimit të sistemit gjyqësor nga OSBE.

Monitorimi i gjyqësorit në mbarë vendin të cilin e realizon OSBE vë në dukje dështimet e gjykatave për t'i respektuar standardet e të drejtave të njeriut e të sundimit të ligjit, qoftë nëpër rajone të caktuara të vendit apo në të gjitha gjykatat. Ky aktivitet i mundëson OSBE-së që këto çështje t'i adresojë më pas nëpërmjet raporteve për tema me interes për sistemin e drejtësisë. Një problematikë që ka tërhequr vëmendjen e monitoruesve të OSBE-së është se sistemi i drejtësisë nuk po arrin të reagojë në mënyrë efektive ndaj çështjeve që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve. Monitoruesit e gjykatave nga radhët e OSBE-së kanë siguruar të dhëna e vëzhgime të evidentuara nga monitorimi i 298 seancave në 168 lëndë nëpër gjykata gjatë periudhës 2017-2019, ku fëmijët ose kanë qenë të përfshirë drejtpërdrejtë si palë në procedurë apo kanë qenë të prekur nga rasti në tjetër mënyrë (për shembull, në procedura të shkurorëzimit apo procedura tjera nga lëmi i së drejtës familjare) të cilat raste janë monitoruar para shtatë gjykatave themelore të Kosovës.<sup>11</sup> Misioni ka monitoruar këto raste specifike meqë ato përputheshin me njërin nga prioritetet kryesore të monitorimit të Misionit, që është dhuna në familje, rastet familjare të shkurorëzimit dhe rastet që përfshijnë trajtimin e barabartë gjinor. Kur gjatë monitorimit të rasteve të sipërpërmendura janë paraqitur shqetësime të lidhura me të drejtat e fëmijës, është parë si e domosdoshme nga perspektiva e të drejtave të njeriut dhe veçanërisht nga perspektiva e të drejtave të fëmijës, që të trajtohen çështjet relevante të vëzhguara gjatë trajtimit të këtyre rasteve.

### 3. Korniza ligjore vendore dhe ndërkombëtare

Përderisa të drejtat e fëmijëve mbrohen me ligje vendore e ndërkombëtare, fëmijët vazhdojnë të përbëjnë kategorinë më të ndjeshme të pjesëmarrësve në procedura gjyqësore. Si ligjet vendore ashtu edhe ato ndërkombëtare i udhëzojnë gjykatat që në punën e tyre të udhëhiqen nga interesi më i lartë i fëmijës. Ndonëse ky parim mund të tingëllojë paksa abstrakt, ai është i mishëruar në ligje dhe shërben si udhërrëfyes pozitiv për kuptimin e funksionit që QPS-të ushtrojnë në gjykatë.

<sup>11</sup> Misioni monitoroi numrin e mëposhtëm të seancave dëgjimore që përfshinin persona të mitur, para secilës prej Gjykatave Themelore: Gjykata Themelore e Prishtinës - 52 seanca; Gjykata Themelore e Mitrovicës - 28 seanca; Gjykata Themelore e Pejës - 9 seanca; Gjykata Themelore e Prizrenit - 59 seanca; Gjykata Themelore e Ferizajt - 6 seanca; Gjykata Themelore e Gjilanit - 41 seanca dëgjimore; Gjykata Themelore e Gjakovës - 103 seanca.

### 3.1. Interesi më i lartë i fëmijës

Parimi i “interesit më të lartë të fëmijës” njihet edhe me Kushtetutë e cila përcakton që

*“[t]ë gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, të ndërmarra qoftë nga institucionet e pushtetit publik, qoftë nga institucionet private, do të jenë në interesin më të mirë të fëmijëve.”<sup>12</sup>*

Më tej, Kushtetuta parasheh që çdo fëmijë gëzon të drejtën për “raporte të rregullta personale dhe kontakte të drejtpërdrejta me prindërit e vet, me përjashtim kur institucioni kompetent përcakton se një gjë e tillë është në kundërshtim me interesat më të mira të fëmijës.”<sup>13</sup> Përgjegjësia për ofrimin e shërbimeve sociale për familjet me fëmijë rregullohet kryesisht me Ligjin për shërbime sociale dhe familjare, që përcakton se

*“[n]ë të gjitha çështjet lidhur me ofrimin e shërbimeve për fëmijë dhe familje, interesi më i mirë i fëmijës duhet të jetë konsiderata e parë dhe më e rëndësishme.”<sup>14</sup>*

Korniza ligjore e Kosovës i pasqyron dispozitat e disa konventave ndërkombëtare në këtë fushë<sup>15</sup> të cilat kërkojnë nga gjykatat që t'i marrin në konsideratë parimet dhe praktikën e së drejtës ndërkombëtare me rastin e zbatimit të kornizës ligjore vendore. Parimi i “interesit më të lartë” është bosht kryesor i Konventës për të Drejtat e Fëmijës<sup>16</sup>, e cila në nenin 3 të saj parasheh që

*“[n]ë të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucione publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese.”<sup>17</sup>*

“Kjo Konventë i jep fëmijës të drejtën që interesat e tij/saj më të lartë të vlerësohen dhe të merren si një konsideratë parësore në të gjitha veprimet apo vendimet që kanë të bëjnë me të, si në sferën publike ashtu edhe atë private.”<sup>18</sup>

Dispozitat e Konventës për të Drejtat e Fëmijës janë drejtpërsëdrejti të zbatueshme në Kosovë<sup>19</sup> dhe konsiderata parësore siç përmendet në nenin 3 nënkupton se interesi më i lartë i fëmijës mbizotëron ndaj të gjitha konsideratave të tjera në një proces gjyqësor dhe se të drejtat për t'i mbrojtur

<sup>12</sup> Shih nenin 50.4 të Kushtetutës, 15 qershor 2008, si dhe ndryshim-plotësimet e kushtetutës, 7 shtator 2012, 26 mars 2013, 5 gusht 2015 dhe 11 mars 2016.

<sup>13</sup> Po aty., Neni 50.5.

<sup>14</sup> Shih nenin 9(1) të Ligjit për shërbime sociale dhe familjare.

<sup>15</sup> Po aty., Neni 22.

<sup>16</sup> Konventa për të Drejtat e Fëmijës (KDF), Rezoluta 44/25 e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara e 20 nëntorit 1989, hyrë në fuqi më 02 shtator 1990.

<sup>17</sup> Po aty., Neni 3, paragrafët 1-3.

<sup>18</sup> Komenti i përgjithshëm nr. 14 [2013] mbi të drejtën e fëmijës që interesat e tij/saj më të lartë të merren si një konsideratë parësore (neni 3, paragrafi 1).

<sup>19</sup> Po aty., Neni 22.

interesat e një fëmije kanë epërsi mbi të drejtat tjera në procedura ligjore. Ky parim njihet edhe nga traktate tjera për të drejtat e njeriut si, për shembull, Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas (CEDAW)<sup>20</sup>, e cila parasheh gjithashtu që interesi më i lartë i fëmijëve është kusht “parësor” ose “kryesor” për prindërit gjatë rritjes së fëmijëve, pavarësisht nga statusi i tyre martesor.<sup>21</sup>

### 3.2. Të drejtat e fëmijës - praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) me vendime të ndryshme i ka vënë konturat e përkufizimit të interesit më të lartë të fëmijës sipas Konventës për të Drejtat e Fëmijës.<sup>22</sup> Në çështjen Z dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar, GJEDNJ i ka njohur “vendimet e vështira e të ndjeshme para së cilave mund të ndodhen shërbimet sociale dhe parimin e rëndësishëm kundërveprues të respektimit e ruajtjes së familjes.”<sup>23</sup> Megjithatë, aty ku shërbimet sociale dështojnë që t'i mbrojnë fëmijët nga “neglizhenca e abuzimi serioz dhe afatgjatë” kemi të bëjmë me shkelje të nenit 3 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNJ).<sup>24</sup> GJEDNJ konstaton se interesi më i lartë i fëmijës mund ta mbizotërojë atë të një prindi, varësisht nga natyra dhe serioziteti i tyre. Në veçanti, prindi nuk mund të marrë masa që do ta dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e fëmijës.<sup>25</sup> Për shembull, parandalimi i çrregullimit të “ekuilibrit emocional dhe psikologjik” të një fëmije mbizotëron ndaj interesit të prindit për ta parë fëmijën në rastet kur fëmija shpreh qartazi dëshirën për të mos e parë atë.<sup>26</sup>

Përveç interesit të mirëqenies emocionale dhe psikologjike që duhet të merret parasysh në përcaktimin e interesit më të lartë të një fëmije, rëndësi kanë po ashtu edhe interesat pronësore<sup>27</sup> të fëmijëve. Në S.L. dhe J.L. kundër Kroacisë, GJEDNJ vendosi që autoritetet vendore kishin dështuar t'i marrin masat e nevojshme për të mbrojtur interesat pronësore të fëmijëve në një këmbim të kontestuar të patundshmërisë.<sup>28</sup> Në rastin në fjalë, qendra për punë sociale kishte argumentuar, megjithëse pa sukses, se këmbimi i patundshmërive nga i cili fëmijët do të merrnin një banesë me vlerë më të vogël se sa ajo e shtëpisë së tyre të dhënë në këmbim nuk binte ndesh me interesin më të lartë të tyre sepse do t'u siguronte fëmijëve akomodim plotësisht të përshtatshëm për jetesë.<sup>29</sup>

<sup>20</sup> Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas (CEDAW), e miratuar në 1979 nga Asambleja e Përgjithshme e OKB.  
<sup>21</sup> Po aty., Nenet 5(b) dhe 16(1)(d).

<sup>22</sup> “Ndonëse GJEDNJ i referohet shpesh KDF-së me rastin e shqyrtimit të kërkesave të parashtuara goftë nga vetë fëmijët apo në emër të tyre, ajo nuk i jep në mënyrë sistematike rëndësi vendimtare. Në disa raste, parimet e të drejtave të fëmijëve siç janë artikuluar nga KDF kanë pasur ndikim të thellë në arsyetimin e GJEDNJ-së, posaçërisht për sa i përket interpretimit të Gjykatës për nenin 6 të KEDNJ (e drejta për një gjykim të drejtë) në lidhje me trajtimin e fëmijëve të cilët bien ndesh me ligjin [shih Kreun 11].” Doracak mbi ligjin evropian në lidhje me të drejtat e fëmijës, në dispozicion tek: [https://www.echr.coe.int/Documents/Handbook\\_rights\\_child\\_ENG.pdf](https://www.echr.coe.int/Documents/Handbook_rights_child_ENG.pdf).

<sup>23</sup> Aktgjykimi i GJEDNJ në çështjen Z dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar, 10 maj 2001, paragrafët 74-75.

<sup>24</sup> Po aty.

<sup>25</sup> Shih Elsholz kundër Gjermanisë [GC], nr. 25735/94, § 50; dhe T.P. e K.M. kundër Mbretërisë së Bashkuar [GC], nr. 28945/95, § 71, ECHR 2001-V; shih gjithashtu Ignaccolo-Zenide kundër Rumanisë, nr. 31679/96, § 94, ECHR 2000-I, dhe Nuutinen kundër Finlandës, nr. 32842/96, § 128, ECHR 2000-VIII).

<sup>26</sup> Sommerfeld kundër Gjermanisë [GC], nr. 31871/96, f. 13.

<sup>27</sup> “Rrjedhimisht, Gjykata duhet ta vlerësojë mënyrën në të cilën kanë vepruar autoritetet vendore për t'i mbrojtur interesat pronësore të fëmijës ndaj çdo veprimi keqdashës ose neglizhent të të tjerëve, përfshirë këtu përfaqësuesit e tyre ligjorë dhe prindërit” S.L. dhe J.L. kundër Kroacisë, 19 tetor 2015, f. 17.

<sup>28</sup> Po aty., f. 23.

<sup>29</sup> Po aty., f. 3.

Mirëpo, Gjykata konstatoi se duke mos u dalë në mbrojtje interesave pronësore të fëmijëve në patundshmërinë me vlerë më të lartë, qendra kishte dështuar që ta mbrojë interesin më të lartë të fëmijëve.<sup>30</sup>

Për më tepër, Gjykata ishte e mendimit se qendra për punë sociale nuk kishte marrë fare në konsideratë në mos në rrethanat e veçanta të rastit do të ishte dashur të caktohej një kujdestar special që do të mund të kishte mbrojtur në mënyrë të paanshme dhe të pavarur interesat e parashtruesve karshi gjithë atyre që ishin të përfshirë në këmbimin e kontestuar të patundshmërisë, përfshirë këtu dhe prindërit e fëmijëve. Në këto rrethana, GJEDNJ konstatoi se qendra nuk e kishte vlerësuar si duhet situatën familjare të parashtruesve dhe ndikimin e mundshëm negativ të marrëveshjes së kontestuar për këmbim të patundshmërive në të drejtat e tyre. Pra, qendra për punë sociale kishte dështuar që të vlerësonte nëse rrethanat e marrëveshjes për këmbim të patundshmërive ishin në pajtim me parimin e interesit më të lartë të fëmijës në rastin në fjalë të ankimuar nga ana e parashtruesve.

## 4. Roli i qendrave për punë sociale në procedurat gjyqësore

Ligji për shërbime sociale dhe familjare parasheh që secila komunë të themelojë një QPS, të cilën e përkufizon si institucion publik “që do të ketë personel të përbërë nga profesionistët me trajnime dhe kualifikime përkatëse.”<sup>31</sup> QPS-ja është e obliguar të bëjë vlerësime profesionale për secilin individ ose familje që jeton ose gjendet në territorin e saj e që kërkon ndihmë prej saj ose “në ndonjë mënyrë tjetër mësohet apo shihet se ka nevojë për shërbime sociale dhe familjare”.<sup>32</sup> Ngjashëm, ky ligj i mandaton QPS-të për t’ju ofruar përkujdesje sociale dhe këshillim “fëmijëve në nevojë.”<sup>33</sup> Në rastet kur gjykata i kërkon të bëjë një vlerësim profesional të rrethanave sociale, organi i kujdestarisë në kuadër të QPS është i obliguar që t’i sigurojë gjykatës një raport brenda njëzet e një dite nga dita e bërjes së kërkesës, përveç nëse në kërkesë nuk është përcaktuar ndryshe.<sup>34</sup> Gjithashtu, Ligji për familjen parasheh që QPS, duke vepruar në cilësinë e organit të kujdestarisë, duhet të ftohet në të gjitha seancat gjyqësore ku kjo e fundit mund të “bëjë propozime për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të fëmijëve, të paraqes fakte të cilat nuk janë përfshirë, të propozojë administrimin e provave të domosdoshme, të ushtrojë mjetet juridike dhe të ndërmer veprime tjera gjyqësore.”<sup>35</sup>

Kodi i drejtësisë për të mitur parasheh detyrimin që një “person mbështetës” nga QPS të mbështesë fëmijët viktime apo dëshmitarë që nga fillimi i fazës hetimore dhe gjatë gjithë procesit gjyqësor.<sup>36</sup>

<sup>30</sup> Po aty.

<sup>31</sup> Shih nenin 7(1) të Ligjit për shërbime sociale dhe familjare.

<sup>32</sup> Po aty., Neni 7(6).

<sup>33</sup> Po aty., Neni 9(3).

<sup>34</sup> Po aty., Neni 14(2).

<sup>35</sup> Shih nenin 6(4) të Ligjit për familjen.

<sup>36</sup> Shih nenin 124, Kodi i drejtësisë për të mitur nr. 06/L-006, 18 tetor 2018.

Personi mbështetës do të marrë pjesë si një profesionist i trajnuar për të komunikuar me fëmijët dhe për t'u dalë atyre në mbrojtje. Theksi është vënë në kohën e mjaftueshme për personin mbështetës që të njihet me fëmijën dhe rastin në fjalë që nga fillimi dhe gjatë gjithë procesit.<sup>37</sup>

Kodi i procedurës penale (KPP) ia ka caktuar gjykatës detyrimin që të sigurojë praninë e të gjitha palëve në gjykimin e çështjes penale.<sup>38</sup> Nëse një palë nuk i përmbahet urdhrin të gjykatës si, për shembull, duke mos u paraqitur në seancë apo duke mos siguruar raporte të ekspertizës, gjykata mund t'u shqiptojë sanksione.<sup>39</sup> Në mënyrë që gjykata t'i vërtetojë saktësisht dhe tërësisht faktet në çështjen penale, asaj duhet t'i sigurohen provat, informatat dhe të dhënat e nevojshme nga të gjitha institucionet burimore kompetente.<sup>40</sup> Kodi i Drejtësisë për të Mitur parasheh detyrimin për autoritetet dhe personat e institucionet tjera të cilëve u kërkohen raporte ose opinione, që marrin pjesë në procedura ku janë të përfshirë të miturit, që të procedojnë në mënyrë të shpejtë dhe pa vonesa të panevojshme.<sup>41</sup>

KPPK-ja, vendimin për vazhdimin apo ndërprerjen e seancës gjyqësore në rastet e mungesës së dëshmitarit ekspert në procedurë, ia ka lënë në diskrecion gjyqtarit.<sup>42</sup> Megjithatë, Kodi i drejtësisë për të mitur thekson se askush nuk mund të përjashtohet nga detyra për të dëshmuar lidhur me rrethanat e nevojshme për vlerësimin e zhvillimit psikologjik të të miturit ose për njohjen e personalitetit të tij dhe të kushteve në të cilat jeton ai.<sup>43</sup>

Në procedurën kundër të miturve, Kodi i Drejtësisë për të Mitur gjithashtu vë theksin në rolin e organit të kujdestarisë që gëzon të drejtën për të qenë i njoftuar për rrjedhën e procedurës; për të parashtruar propozime dhe prova që janë të rëndësishme për marrjen e një vendimi të drejtë.<sup>44</sup>

Si përmbledhje, gjykatat duhet ta ushtrojnë autoritetin e tyre për të siguruar praninë e të gjitha palëve të ftuara, për të udhëzuar, edukuar dhe nëse është e nevojshme për ta sanksionuar organin e kujdestarisë apo ndonjë palë tjetër në procedurë e cila mungon, për të siguruar respektimin e urdhrave të gjykatës dhe për të përmbushur kushtin ligjor për praninë e tyre. U takon gjykatave që të udhëzojnë institucionet e përfshira në një proces gjyqësor që të përgjigjen në mënyrë të duhur dhe efektive ndaj çfarëdo pyetjeje që mund të ketë gjykata për zgjidhjen e lëndës, posaçërisht kur janë të përfshirë fëmijët me qëllim që të respektohet parimi i 'interesit më të mirë të fëmijës'. Kur institucionet jogjyqësore nuk i përmbahen urdhrave të gjykatës, kjo jo vetëm që ka ndikim negativ në të drejtat e palëve në një lëndë gjyqësore, por edhe ul besueshmërinë e gjykatave dhe rrjedhimisht dobëson besimin e qytetarëve në sistemin e drejtësisë.

<sup>37</sup> Po aty., Neni 125.

<sup>38</sup> Shih nenin 64 të Kodit të procedurës penale (KPP). Neni 287(5) i KPP-së përcakton që "i akuzuari, dëshmitari dhe eksperti njoftohen në thirrje për pasojat e mosparaqitjes në shqyrtimin gjyqësor." Neni 309 parasheh veprime gjyqësore në rastet e mosparaqitjes së dëshmitarit apo ekspertit në shqyrtim gjyqësor.

<sup>39</sup> Shih nenet 135 dhe 309 të KPP-së, si dhe nenin 6(4) të Ligjit për familjen.

<sup>40</sup> Shih nenin 7, KPP.

<sup>41</sup> Shih nenin 40(1) të Kodit të drejtësisë për të mitur.

<sup>42</sup> Shih nenin 309 të KPP.

<sup>43</sup> Shih nenin 46 të Kodit të drejtësisë për të mitur.

<sup>44</sup> Po aty., Neni 45.



## 5. Intervistat dhe diskutimet me aktorët kryesorë që janë të përfshirë në mbrojtjen e fëmijëve<sup>45</sup>

OSBE-ja ka kontakt të shpeshtë me gjyqtarët, prokurorët, avokatët, policinë, mbrojtësit e viktimave, përfaqësuesit e QPS-ve dhe kuadrin tjetër gjyqësor dhe jogjyqësor për shkak të natyrës së programit të monitorimit. Gjatë intervistave dhe diskutimeve të ndryshme me profesionistët gjyqësor mes vitit 2017 dhe 2019, vazhdimisht u ngrit çështja e punës së QPS. Çështjet që u ngritën pasqyrojnë shqetësimet kryesore në raport; domethënë, përfaqësuesit e QPS duket se nuk paraqiten në gjykatë kur thirren, mund të jenë joaktivë gjatë procedurave dhe/ose i paraqesin raportet me vonesë apo me mangësi.

Gjatë një takimi në nëntor të vitit 2019, një përfaqësues i Policisë së Kosovës deklaroi se QPS duhet të ketë një rol më aktiv për mbrojtjen e fëmijëve; megjithatë, ata nuk kanë burime të mjaftueshme. Në tetor të vitit 2019, gjatë një takimi, një prokuror ngriti çështjen e mungesës së bashkëpunimit mes QPS-ve dhe gjykatave, duke rezultuar kështu në vonesa procedurale dhe/ose mosarritjen e afateve që përcaktohen me anë të ligjit. Në një intervistë me një gjyqtar në shtator të vitit 2019, gjyqtari tregoi se përfaqësuesi i QPS dukej se ngurronte të paraqitej në gjykatë ndërsa merrte pjesë rregullisht vetëm në rastet kur prindi ishte kryerësi i dhunës dhe fëmija ishte viktimë, në vend se t'i përgjigjet thirrjeve në të gjitha rastet. Në shtator të vitit 2019, një prokuror i paraqiti vërejtjet e tij se QPS nuk monitorojnë zbatimin e vendimeve në rastet ku janë të përfshirë fëmijët apo të urdhrave mbrojtës në rastet e dhunës në familje, në vend se të përgjigjej në të gjitha ftesat në të gjitha rastet. Në shtator të vitit 2019, një prokuror ndau mendimin personal se QPS-të nuk përcjellin zbatimin e vendimeve në rastet që përfshijnë fëmijë, apo të urdhrave për mbrojtje nga dhuna në familje.

Gjatë një takimi me një QPS në shtator të vitit 2019, personeli tregoi se prioritet i tyre gjithnjë është mirëqenia e fëmijës, sidoqoftë ata janë shumë të kufizuar për shkak të mungesës së financimit të mjaftueshëm. Në qershor të vitit 2019, një pjesëmarrës në një tryezë të rrumbullakët për përmirësimin e qasjes në drejtësi ngriti çështjen që përfaqësuesi i QPS ose nuk është në dispozicion, ose është shumë e vështirë për të vënë kontakt pas orarit të punës dhe/ose gjatë fundjavës. Përveç kësaj, pjesëmarrësi deklaroi është e nevojshme që të ketë komunikim të përmirësuar mes të gjitha autoriteteve gjegjëse. Një përfaqësues i QPS tregoi, gjatë një tryeze të rrumbullakët në nëntor të vitit 2018, se është e rëndësishme që të respektohen të drejtat e fëmijës gjatë gjithë kohës, megjithatë në të njëjtin takim mbrojtësi i viktimave shprehu shqetësimin e tyre që përfaqësuesit e QPS nuk ishin në dispozicion pas orarit të punës dhe se nuk po marrin pjesë rregullisht në seancat e gjykatës.

<sup>45</sup> Pikëpamjet dhe mendimet që janë shprehur më poshtë janë të aktorëve të caktuar që janë të përfshirë në rastet e mbrojtjes së fëmijës. Shih nenin 124, Kodi i drejtësisë për të mitur nr. 06/L-006, 18 tetor 2018.

Gjatë takimeve në tetor të vitit 2018 dhe tetor të vitit 2019, përfaqësuesit e QPS-ve deklaruan se ata kanë qasje të kufizuar në automjete dhe prandaj nuk kanë se si të udhëtojnë deri në gjykatë kur janë të thirrur. Gjatë një takimi në dhjetor të vitit 2017, një gjyqtar tregoi se mungesa e shpeshtë e QPS-ve gjatë seancave përbënte shqetësim dhe se raportet për gjendjen e familjes, kujdestarinë, ushqimin dhe rekomandimet për kontaktin me prindin shpesh janë të mangëta. Kjo shkakton vonesa të mëtejme për gjykimin e një rasti, ku interesi më i mirë i fëmijës është i rëndësishëm parësor.

## 6. Performanca e qendrave për punë sociale

OSBE-ja ka vërejtur disa mangësi serioze të drejtave të njeriut në gjykimin e lëndëve që përfshijnë fëmijët në gjykatat e Kosovës. Këto përfshijnë si në vijim: lëndët që kanë të bëjnë me kujdestarinë, kontaktin dhe përkrahjen financiare për fëmijët; kërkesat për urdhra mbrojtës në rastet e dhunës në familje si dhe një mori të lëndëve të tjera, lëndë civile dhe penale ku janë të përfshirë fëmijët. Në të gjitha këto fusha, monitorimi nga OSBE-ja ka identifikuar një mori të metave procedurale dhe materiale që do të mund të përbëjnë shkelje të drejtave të fëmijëve në fjalë. Shkeljet e veçanta dallojnë nga njëra fushë në tjetrën; megjithatë, temë e përbashkët e të gjitha prej tyre është dështimi i QPS-ve për të reaguar ashtu siç duhet dhe që në fund gjykata të merr parasysh interesin më të mirë të fëmijës.

Shqetësimet e OSBE-së përqendrohen në dy funksione kryesore të përfaqësuesve të QPS-ve: së pari, mungesa e punëtorit social të QPS në seancat gjyqësore, kur atyre u kërkohet që të shërbejnë si person mbështetës, dhe së dyti, raportet e mangëta për kujdestarinë e fëmijës, ushqimin dhe mbajtjen e kontakteve personale mes fëmijës dhe prindërve.

Në 298 seanca gjyqësore të monitoruara nga OSBE-ja në gjykatat në të gjithë Kosovën e të cilat përfshinin fëmijë<sup>46</sup>, prania e QPS u kërkua me ligj në 152 seanca, ndërsa përfaqësuesit e QPS-së ishin të pranishëm në vetëm 43 seanca. Në katër nga ato seanca kur stafi i QPS ishte i pranishëm, është konsideruar se ata nuk ishin aktivë sa duhet për t'i mbrojtur interesat më të mira të fëmijës dhe nuk paraqitën fare kontribut gjatë seancave. Mungesa e zyrtarëve të QPS në së paku 74 seanca dëgjimore nuk u sqarua. Ata janë thirrur nga gjykata në mënyrë të rregullt, por nuk u paraqitën në gjykatë. Në dy raste, gjykata nuk kishte dërguar thirrje për QPS-në ose i mungonte prova që dëshmonte se QPS ishte thirrur në mënyrë të rregullt. Në 33 seanca, informacioni mbi thirrjen gjyqësore nuk u përmend ose nuk ishte në dispozicion.

Në anën tjetër, në nëntë raste që përfshijnë urdhrat mbrojtës për rastet e dhunës në familje, QPS ishin proaktive dhe ofruan përkrahje, udhëzime dhe mbrojtje për interesat e palëve të mbrojtura si dhe për fëmijët e palës së mbrojtur.

<sup>46</sup> Rastet e monitoruara dhe të raportuara mes viteve 2017 dhe 2019.

Rastet shembuj në vijim ilustrojnë shumë prej mangësive të lartcekura.

Që shumë vite, paditësi dhe i padituri ishin partnerë sipas të drejtës zakonore dhe kishin fëmijë bashkë, të gjithë nën moshën 18 vjeçare. Çifti u nda në vitin 2014 dhe që nga ajo kohë fëmijët vazhduan të jetonin me nënën e tyre dhe prindërit e saj. Paditësi (nëna) e kërkoi kujdestarinë për fëmijët dhe që babai të takohej me fëmijët në përputhje me një marrëveshje që ishte arritur mes palëve. Në njërën prej dëgjimeve pranë gjykatës, gjykata njoftoi palët se punonjësi i QPS kishte dorëzuar një raport që ishte i paplotë (mungonin rekomandimet për mënyrën e mbajtjes së kontakteve personale dhe me gjasë përmbante emrin e pasaktë të nënës së fëmijëve). Përfaqësuesi i QPS, i cili ishte thirrur sipas rregullit nga gjykata për dëgjim, dështoi që të paraqitej. Palët bashkërisht propozuan që të thirrej punonjësi i QPS në seancën kryesore me qëllim që të korrigjoheshin gabimet në raport. Në dëgjimin e radhës, përfaqësuesi i QPS mungoi prapë, ndonëse ishte thirrur sipas rregullit. Në këto rrethana, avokati i paditësit i propozoi gjykatës shtyrjen e seancës për një datë tjetër.

Në një rast tjetër, OSBE-ja vërejti mungesën e çfarëdo kontributi nga ana e QPS:

Gruaja kërkoi shkurorëzim, duke qenë se raportet bashkëshortore me burrin e saj ishin çrregulluar rëndë dhe vazhdimisht, dhe martesë e tyre ishte e pandreqshme. Çifti kishte tre fëmijë të mitur nga kjo martesë dhe paditësi (gruaja) nuk kërkoi që t'i caktohej kujdestaria për fëmijët. Në vend të kësaj, ajo kërkoi që gjykata të vendoste për kontaktet personale mes saj dhe fëmijëve të saj të mitur, kujdestaria e së cilëve, sipas mendimit të saj, do të duhej t'i caktohej babait të tyre, të paditurit. Gjykata nuk i kërkoi QPS që të ofronte një kontribut cilësor për këtë çështje juridike. Përveç kësaj, gjykata mbeti e heshtur për punën joefektive të QPS për çështjet për të cilat ky institucion është i autorizuar me anë të ligjit për të qenë pikë reference për ofrimin e ndihmës, kontributit dhe informatave kthyese.

Monitoruesit e OSBE-së kanë vërejtur se në të dyja rastet ka munguar kontributi i QPS-ve. Në rastin e parë, raporti i pasaktë i përfaqësuesit të QPS nuk e ndihmoi gjyqtarin për përcaktimin e fakteve të plota të rastit dhe dështimi i tyre për t'u paraqitur dy herë çoi në shtyrjen e dy seancave, duke ndikuar kështu drejtpërdrejtë në kushtin që përcakton trajtimin me urgjencë të rasteve që përfshijnë fëmijët, domethënë brenda afatit sa më të shkurtër kohor. Në rastin e dytë, ndihma e QPS ishte dashur t'i mundësonte gjykatës vlerësimin e plotë të gjitha fakteve që kanë të bëjnë me lëndën, me qëllim të përcaktimit të interesit më të mirë të fëmijës;<sup>47</sup> përfshirë zotësinë prindërore të nënës dhe babait dhe çfarëdo çështje që motivonte kërkesat e tyre gjegjëse drejtuar gjykatës (domethënë, vetëm për caktimin e kontaktit, përkatësisht për kujdestari të plotë).

<sup>47</sup> Shih nenet 140(2) dhe 146 të Ligjit për Familje.

Në rastin në vijim, arsyeja e mungesës së QPS ishte jashtëzakonisht shqetësuese:

Prokuroria pretendonte se të paditurit, burri dhe gruaja, nuk kishin mjete për t'i mbuluar shpenzimet e strehimit dhe, përkohësisht, braktisën fëmijët e tyre duke i lënë në kushte jetese nën standarde. Aktakuza u ngrit dhe akuzonte që të dy për abuzim apo braktisje të fëmijës sipas nenit 250(2) të kodit penal në fuqi në kohën e veprës. Në seancën fillestare përfaqësuesi i QPS mungoi dhe e shpjegoi mungesën me mungesë transporti. Të dy të paditurit e pranuan fajin, pas së cilës gjyqtari menjëherë u shqiptoi të dyve dënimin e pezulluar prej 180 ditëve me burg për një periudhë sprovuese prej një viti.

Monitoruesit e OSBE-së vërejtën disa mangësi në këtë rast. Gjykata nuk mori mendimet e QPS para marrjes së vendimit, prandaj, gjykata nuk siguroi zbatim të rregullave materiale. Për më tepër, mungesa e QPS në seancë, përkundër se thirrja ishte dërguar në mënyrë të rregullt, nuk u sanksionua nga ana e gjykatës. Për shkak se QPS nuk siguroi asnjë kontribut material në këtë rast gjykata shqiptoi dënimin pa e dëgjuar deklaratën e QPSs- lidhur me rrethanat e përgjithshme që ndikonin në mirëqenien mendore dhe fizike të fëmijëve. Një gjë e tillë jo vetëm që minimizon rolin e QPS-ve në procedura gjyqësore, por edhe nxit një praktikë të dëmshme të mungesave pa arsyetim të vlefshëm, duke zbehur obligimin e llogaridhënies nga ana e institucioneve. Këto shqetësime janë të pranishme edhe në rastin si në vijim.

Rasti në vijim është shembull i mungesës së QPS në një rast, në të cilën roli i tyre ishte vendimtar, si dhe i mungesës së veprimeve nga gjykata për ta trajtuar këtë mungesë ashtu siç duhet:

Paditësi (babai) parashtroi një kërkesë me anë të së cilës kërkonte nga gjykata që të rregullonte kontaktet personale mes tij dhe fëmijëve të tij. Në seancën dëgjimore të caktuar pranë gjykatës, punonjësit e QPS, domethënë, kujdestarët e autorizuar të caktuar për fëmijët e paditësit, munguan edhe pse ishin thirrur sipas rregullave. Disa prova u paraqitën; megjithatë, seanca dëgjimore u shty për të marrë një raport shtesë nga QPS-ja për ndikimin e vizitave në gjendjen mendore të fëmijëve. Përkundër asaj se ky informacion u kërkua në disa raste, QPS-ja dështoi që ta siguronte atë. Gjykata nuk i përdori masat gjyqësore në dispozicion, të tilla si shqiptimi i një gjobe sipas nenit 293 (1) të Ligjit për Procedurën Kontestimore që përcakton bazën për një masë të tillë, posaçërisht duke pasur parasysh vonesën që QPS-ja po e shkaktonte duke mos e dhënë raportin që ishte kërkuar nga ajo për më shumë se një herë.

Dështimet e përfaqësuesve të QPS-ve për t'u paraqitur në gjykatë dhe për të ofruar dëshmi lidhur me rrethanat që ndikojnë mirëqenien e një fëmije, përfshirë interesin e tij/saj më të mirë, si dhe praktikën e gjykatës për të qenë mospërfillëse ndaj sjelljes së tillë që rezultojnë në shtyrje të përsëritura, është në kundërshtim me shumë kërkesa të drejtave të njeriut përkitazi me interesin më të mirë të fëmijës dhe urgjencës së rasteve ku janë të përfshirë

fëmijët. Mosdëshkimi lidhur me praktikat e mosrespektimit nga ana e institucioneve vetëm sa inkurajon përsëritjen e vazhdueshme të praktikave të tilla dhe përbën shkelje të drejtave të njeriut.

OSBE-ja është e shqetësuar se këto mangësi shkelin të drejtat e fëmijëve të cilët iu nënshtrohen procedurave të tilla, duke qenë se këto të drejta garantohen edhe me konventat ndërkombëtare që zbatohen drejtpërdrejtë në Kosovë<sup>48</sup>, edhe me legjislacionin vendor siç është shtjelluar në pjesën e mëparshme.

Gjatë periudhës raportuese, Misioni monitoroi 43 raste kur stafi i QPS ishte i pranishëm në rastet që përfshinin të mitur. Rastet e mëposhtme janë shembuj të praktikave më të mira që përfshijnë fëmijë dhe ku është vërejtur se përfaqësuesit e QPS kanë ofruar informata të nevojshme për gjykatën. Një shembull është si më poshtë:

Një shembull pozitiv i praktikave të mira që përfshin fëmijët dhe ku përfaqësuesit e QPS i japin informatat e nevojshme gjykatës është si në vijim:

Në shtator të vitit 2019, u kërkua një urdhër mbrojtje kundër burrit/babait pas dhunës që pretendohet se kishte ushtruar ndaj anëtarëve të ndryshëm të familjes në gusht të vitit 2019. Për shkak se njëri nga parashtruesit e kërkesës ishte vajza e mitur e kryerësit, QPS-ja u kontaktua me anë të një njoftimi të shkurtër për të marrë pjesë në seancë dëgjimore. Përkundër njoftimit të shkurtër, QPS-ja ishte në gjendje që të merrte pjesë në seancë dëgjimore. Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesi i QPS mbrojti viktimat e pretenduara, posaçërisht kur vajza e mitur dëshmoi para gjykatës për veprimet e dhunshme të babait të saj. Në mbyllje të seancës dëgjimore, QPS-ja i kërkoi gjykatës që t'ia jepte kopjet e dokumenteve në dosjen e lëndës me qëllim që të përgatiste një raport të plotë dhe të kompletuar për të ndihmuar vendimin e gjykatës. Gjykata shqiptoi një urdhër mbrojtje për gjashtë muaj.

Një rast tjetër dëshmon se veprimet pozitive dhe punëtorët e përgaditur të QPS kontribuuan në përcaktimin e shpejtë të kërkesës për urdhër të mbrojtjes:

Në mars 2017, një nënë e tre të miturve kërkoi urdhër mbrojtjeje kundër partnerit të saj, me të cilin kishte lidhje zakonore, dhe babait të fëmijëve të saj, pas përkeqësimit të marrëdhënies së tyre, e cila arriti kulmin me veprime të dhunshme nga babai. Gjatë seancës për urdhër të mbrojtjes, përfaqësuesi i QPS ishte i pranishëm, aktiv dhe tregoi njohuri të qarta për situatën e familjes. Gjykatësi dëgjoi dëshmitë nga secila palë, përfshirë mendimin e përfaqësuesit të QPS, prania dhe deklarata e të cilit ndihmuar gjykatën në shqyrtim të rastit.

<sup>48</sup> Shih nenin 22, fusnota 12 më sipër.



## 7. Përfundime

Roli i QPS-ve si organ kujdestarie është thelbësor për shkak të rolit të tyre për dhënien e ekspertizës dhe informatave të nevojshme që janë jetike për përcaktimin e plotë të fakteve, me qëllim që gjykata të merr aktgjykim të prerë dhe të paanshëm, duke pasur parasysh interesin më të mirë të fëmijës.

Gjykatat duhet të sigurojnë se ky rol i QPS-ve zbatohet në mënyrë efektive dhe në përputhje të plotë me kushtet e përcaktuara ligjore, duke kërkuar llogari kur ato nuk përmbushin obligimet e tyre ligjore. Gjykatat kanë autoritetin e plotë për të udhëzuar QPS lidhur me përmbajtjen e nevojshme të raporteve të tyre dhe nivelin e performancës në përputhje me autorizimet e institucionit të tyre. Mangësitë e institucioneve që mbështesin sistemin e drejtësisë pashmangshëm pasqyrohen në punën e sistemit të drejtësisë si tërësi dhe rezultojnë me praktika që nuk janë në përputhje me legjislacionin e Kosovës apo standardet ndërkombëtare. Në rastet ku janë të përfshirë fëmijët, vetë fakti se fëmijët nuk mund të mbrojnë plotësisht të drejtat e tyre të garantuara me ligj, ngarkojnë me përgjegjësi të rëndësishme institucionet që janë të përfshira për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e tyre më të mira.

Raporti mes gjykatave dhe QPS-ve duhet të nxitë mbrojtjen dhe promovimin e interesit më të mirë të fëmijëve, e që është aspekt i rëndësishëm jetike. Sidoqoftë, siç u shtjellua më sipër, në këtë fushë janë vërejtur mangësi. Përfshirja e QPS-ve në procedurat gjyqësore është paraparë që të funksionojë si mbrojtje e të drejtave të fëmijëve, të cilëve u duhet mbrojtje e veçantë për shkak të pozitës së tyre të cenueshme në shoqëri. Siç theksohet nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut i Këshillit të Evropës në vitin 2010: “Drejtësia, shkollat, administratat dhe qytetet duhet të bëhen me të vërtetë të thjeshta e miqësore ndaj fëmijëve [...] Parimi i interesit më të mirë është rregull procedural që rregullon atë se si marrim vendime lidhur me fëmijët. Është një rregull i detyrueshëm ligjor që të gjitha juridiksionet duhet t'i binden. Rregulli nuk përcakton se interesat e fëmijës duhet gjithnjë të merren parasysh, e as nuk avokon se të drejtat e të tjerëve duhet të shkelen. Megjithatë, ajo për çka bën thirrje është një shqyrtim më i saktë i interesave të një grupi posaçërisht të cenueshëm. Prandaj, ndonëse interesi më i mirë i fëmijës nuk mund gjithnjë të jetë çështja e vetme që duhet të merret parasysh, ai megjithatë duhet të jetë një nga prioritetet kryesore dhe duhet të peshohet gjerësisht në të gjitha vendimet që prekin fëmijët.

*“Në sistemin e drejtësisë penale, [...] gjyqësori duhet të jetë hallka e fundit e zinxhirit pasi që të shteret çdo mjet tjetër i mundshëm në përpjekje për të parandaluar dërgimin e rasteve në gjykatë. Mbështetja për familjet në rrezik, veprimi i vendosur në rastet e dhunës në familje, punëtorët social me kapacitet të ndërgjegjësimit, rrjetet e lagjeve dhe një shkollë ku ka jo vetëm-*

*mësimdhënie, por edhe kujdes për çdo fëmijë, janë komponentët kryesorë të një strategjie parandaluese. Natyrisht, vetë fëmijët duhet të jenë të përfshirë në këto përpjekje dhe nuk duhet të konsiderohen thjesht si subjekte që duhet të socializohen dhe kontrollohen”<sup>49</sup>*

Prania dhe ekspertiza e QPS-ve është thelbësore për përmbushjen e kushteve të ligjit dhe për të siguruar se institucionet e Kosovës përmbushin obligimet që janë të përcaktuara me kornizën ligjore ndërkombëtare dhe atë vendore. Nevojiten përpjekje më të mëdha, nga ana e institucioneve gjegjëse, për të siguruar se ky element jetik në sektorin social dhe atë të drejtësisë ofrohet kurdoherë që kërkohet dhe se përmbush standardet e larta të nevojshme për këtë fushë të rëndësishme dhe të ndjeshme të punës së gjykatave.

## 8. Rekomandime

Duke pasur parasysh këto gjetje, OSBE-ja rekomandon si në vijim:

### Për Ministrinë e Shëndetësisë:

- Ministria duhet të ndërmerr hapa për të siguruar trajnime për stafin e QPS-ve me qëllim të zbatimit të duhur dhe përkatës të dispozitave të Ligjit për Familjen dhe Shërbimet Sociale që rregullon mbrojtjen e fëmijës, si dhe
- Ministria të sigurojë mbështetje të mjaftueshme logjistike dhe hapësira për QPS-të, me qëllim që ato t'i përmbushin obligimet e tyre që përcaktohen me ligj duke përfshirë, kudo që të jetë e mundur, opsione të përshtatshme transportimi për personelin e QPS për të qenë në gjendje për t'u paraqitur në gjykatë.

### Për komunitat:

- Çdo komunë duhet të sigurojë se QPS-të në territorin e tyre të kenë resurse të duhura sipas standardeve që saktësohen nga Ministria për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare.

### Për Qendrat për Punë Sociale:

- QPS-të dhe gjykatat duhet të përmirësojnë bashkëpunimin e tyre për të siguruar se fëmijët kanë mbrojtje të nevojshme në përputhje me parimin e interesit më të mirë të fëmijës, që praktikisht përkthehet në një mori mekanizmesh në të gjitha procedurat gjyqësore;

<sup>49</sup> Qëndrimet për të Drejtat e Fëmijëve; Komisionari për të Drejtat e Njeriut i Këshillit të Evropës, Strasburg, 3 maj 2010, CommDH/Letër Qëndrim (2010) 1.

- QPS-të duhet t'i respektojnë urdhrat e gjykatës; në veçanti, thirrjet e gjykatave ku kërkohet prania e tyre në dëgjime gjyqësore që përfshijnë fëmijët dhe të ofrojnë kontribut cilësor siç urdhërohen nga gjykata, si dhe
- QPS-të duhet të ofrojnë ndihmë për gjykatat kurdoherë që një gjë e tillë kërkohet nga ato, duke marrë pjesë në mënyrë aktive në seanca dëgjimore të gjykatës dhe duke ofruar kontribut cilësor dhe me kohë, vlerësime ekspertize dhe mendime në të gjitha procedurat që përfshijnë fëmijët.


#### **Për Gjykatat:**

